



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE NË MITROVICE/ OPŠTINSKI SUD U MITROVICI/ MUNICIPALCOURT IN MITROVICA

C.nr.78/2008

GJYKATA KOMUNALE NE MITROVICE, Gjyqtari Skender Shala, ne qeshtjen juridike te paditesit: _____ nga Mitrovica, te cilin e perfaqeson Avokati _____ nga Mitrovica, sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditurve dhe _____ nga Mitrovica, tani me vendbanim te panjohur, te cilet i perfaqeson perfaqesuesi i perkohshem Avokati _____ sipas aktvendimit te kesaj gjykate, baza e kontestit: Vertetim pronesie, vlera e kontestit 1200,00 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor dhe publik, te dt.10.01.2012, jep kete:

A K T G J Y K I M

I – APROVOHET, Kerkespadia e paditesit dhe **VERTETOHET** se paditesi _____ eshte pronar i paluajtshmerise, pjeses se parceles katastrale nr.2700/1, me kulture Are, e klases 3, ne vendin e quajtur “Nemanjjina”, me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne siperfaqe prej **S=212m2**, sipas certifikates se pronesise nr.54 ZK Mitrovica, e cila evidentohet ne emer te _____) ½ dhe _____) ½ dhe pjeses se parceles katastrale nr.2700/14 me kulture are, klasa 3 ne vendin e quajtur “Nemanjjina” me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne siperfaqe prej **S=19m2**, sipas certifikates se pronesise nr.54 ZK Mitrovica, e cila evidentohet ne emer te _____) ½ dhe _____) ½.

II – OBLIGOHEN te paditurit qe t’ia njohin kete te drejte paditesit dhe t’i lejojne qe paditesi kete paluajtshmeri ta regjistroj ne emer te tij, ne librat e tokes te Zyra Kadastrale Komunale ne Mitrovica, ne afatin prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi, nen kercenim te permbarimit te dhunshem.

- Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

A r s y e t i m

Paditesi ne padin e tij te parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tij ne seancat e mbajtura ka theksuar se i njehti para 30 viteve e ka blere paluajtshmerin e cekur ne dispozitiv dhe qe nga momenti i shitblerjes paditesi se bashku me familjen e tij ka hyre ne posedim te prones, ku i njehti ne vazhdimesi e ka shfrytezuar pa asnje lloj kufizimi apo pengese. Paditesi tani vone ka kuptuar qe paluajtshmeria e cila eshte ne posedim faktik te tij qe nga blerja e saj nuk evidentohet ne emrin e tij, andaj, ka interes juridik qe kjo paluajtshmeri edhe juridikisht te evidentohet ne emrin e tij.

Pasi qe te paditurit jane ne adrese te panjohur i propozoje gjykates qe te ua caktoi perfaqesuesin e perkohshem.

I autorizuari i paditesit ne seancen e shqyrtimit kryesore dhe ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padite dhe precizimin e kerkespadive te paditesve t'i aprovoi si te bazuara, ngase paditesit keto paluajtshmeri i kane fituar ne baze te mbajtjes ne mirebesim mbi 20 vite, dhe ate posedim te panderprere e te papengueshem, ne baze te nenit 40 te Ligjit per pronesine dhe te drejttat tjera sendore.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesve e konform nenit 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK-es, gjykata me aktvendimin C.nr.78/2008 te dt.21.04.2011, te paditurve iu caktoi Perfaqesuesin e perkohshem, Avokat _____ i cili ne baze te ketij aktvendimi do t'i ushtron te drejttat dhe detyrimet, konform nenit 82.1.2 te LPK-es.

Perfaqesuesi i perkohshem i te paditurve ne pergjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise te paditesit ne shqyrtimin kryesor dhe ne fjalen perfundimtare deklaroi se i propozoi gjykates qe ne baze te vleresimit real te provave te nxjerrura ne shqyrtimin e sotem te bie vendim meritor.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor, zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: certifikaten mbi pronesine nr.54 ZK Mitrovice, ne emer te te paditurve e dt.25.01.2008, lexoi ekspertizen ne emer te eksperteve gjeodet _____ dhe _____ te dt.08.12.2011, beri veshtrim ne skicat e tercnit, ndegjoi deshmitaret, _____ dhe _____ dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga Certifikata mbi te drejttat e prones se paluajtshme te cekur me lart, konstatohet se parcela katastrale nr.2700/1 dhe 2700/14, evidentohen ne emer te te paditurve dhe ate: _____ ½ dhe _____

Nga konstatimi dhe mendimi i eksperteve gjeodet te cekur me lart, konstatohet se pas matjeve te kryera te pjeseve kontestuese te paluajtshmerive nga ana e eksperteve gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit, me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Kadastrit ne Mitrovice, kane vertetuar se paluajtshmerite kontestuese bijne – gjegjesisht e perbejne pjesen e parceles te cekura me larte me masa dhe kufij te shenuara si ne ekspertizat e dhena me shkrime dhe skicat e terenit, te cilat jane pjese perberse te ketyre ekspertizave dhe te aprovuara si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Deshmitari . deklaroi se ai personalisht e din se e ka blere paluajtshmerine nga shitesit vllezerit dhe ne vitin 1963, e ka blere pronen, ne siperfaqe rreth 3 ani, me cmim te shitblerjes prej 25000 Dinar te atehershem per tere paluajtshmerin, te cilin cmim ai e ka paguar ne tersi. E di se shitblerja eshte bere ne baze te marreveshjes gojore, i njejti e di se ka ndertuar shtepi nje kateshe dhe te njejten e ka shfrytezuar me anetaret e familjes edhe tash e tutje e shfrytezon pa nderprere, pa kurfar pengesash nga askush. Keto te dhena mua me jane te njohura per arsye se une kam jetuar ne fqinjesi me paditesin Ne pyetje te perfaqesuesit te perkohshem i njejti deklaroi se ai ka qene prezent kur paditesi ia ka paguar te hollat te paditurve dhe se prej se eshte blere paluajtshmeria nuk ka pas kurfar padie kunder paditesit.

Deshmitari deklaroi se ai peronalisht e din se se Mehmet Neziri e ka blere paluajtshmerine nga shitesit vllezerit dhe ne vitin 1963, e ka blere pronen, ne siperfaqe rreth 3 - 4 ani, me cmim te shitblerjes prej 25000 Dinar te atehershem per tere paluajtshmerin, te cilin cmim ai e ka paguar ne tersi dhe se une kam qene present kur eshte bere pagesa e cmimit te shitblerjes. E di se shitblerja eshte bere ne baze te marreveshjes gojore, i njejti e di se ka ndertuar shtepi nje kateshe dhe te njejten e ka shfrytezuar me anetaret e familjes edhe tash e tutje e shfrytezon pa nderprere, pa kurfar pengesash nga askush. Keto te dhena mua me jane te njohura per arsye se une kam jetuar ne fqinjesi me paditesin Ne pyetje te perfaqesuesit te perkohshem i njejti deklaroi se me rastin e dorzimit pranim te parave te cmimit te shitblerjes prezent ka qene edhe deshmitari

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me lart, gjykata erdhi ne perfudim dhe konstatoi se patundshmerin tani lendore e ka blere paditesi, ne baze te marreveshjes gojore mbi shitblerjen ne periudhen kohore 1963, me cmim te shitblerjes nga 25000 (njezet e pese mije) Dinar te atehershem per tere paluajtshmerine, te cilin cmim ne tersi i'a kane paguar te paditurve, ne cilesi te shitesit, te cilet menjeher i'u ka lene ne disponim dhe shrytezim te lire keto paluajtshmeri - bleresve, tani paditesve, te cilet se bashku me anetaret e familjes se tyre, i kane shfrytezuar pa pengesa qe nga momenti i shitberjes e tani e tutje e shfrytezon.

Ne baze te nenit 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat e tjera sendore, Ligji nr.03/L-154, eshte peregaktuar se: Personi i cili me mirebesim e ka 20 (njezet) vjet ne posedim te panderprere nje paluajtshmeri ose nje pjese te saj e fiton pronesin ne te.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes, paditesit e kane pasur ne shfrytezim dhe disponim te lire keto paluajtshmeri dhe ate: me mirebesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ne anen e paditesve ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronesise ne baze te mbajtjes e keto jane: mbajtja me mirebesim, koha e nevojshme si dhe shfrytezimi i papengueshem i ketyre paluajtshmerive.

Mbajtja me mirebesim ekziston se paditesit keto paluajtshmeri i kane blere nga pronari i saj, cka vertetohet nga fleta poseduese ne emer te paditurit.

Koha e nevojshme mbi 20 (njetzet) vite, ekziston sepse paditesit i kane blere keto paluajtshmeri nga i padituri, qysh nga viti 1984.


Gjithashtu nga momenti i shitblerjes, paditesi ka hyre ne posedim dhe shfrytezim te lire dhe te papengueshem te ketyre paluajtshmerive te tij, gjere me tani. Prandaj, gjykata konkludon, se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesit ne menyre – derivative – me mbajtje, konform nenit 40 te Ligjit per Pronesin dhe te Drejtat te Tjera Sendore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedure kontestimore, bazaohet ne baze te nenit 450 dhe 459 te LPK-es.

Nga te cekurat me lart u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA KOMUNALE NE MITROVICE
C.nr.78/2008 dt.10.01.2012.

Gjyqtari,
Skender Shala



KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi mund te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 (pescembedhjet) diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Qarkut ne Mitrovice e permes kesaj gjykate.

Saktesin e pershkrimet e verteton: